

STATUTI
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"IRIS&CO" SHPK

KREU I

Pjesa e pergjithshme

Ky statut, akti i themelimit dhe Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", rregullojne* marredheniet midis ortakeve te* shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "**IRIS&CO**" SHPK.

KREU II

Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarise, Kohezgjatja, Deget dhe Zyrat e Perfaqesimit, Pergjegjesia e Ortakeve

NENI 1

Emri

1.1 Shoqeria tregtare mban emrin "**IRIS&CO**" SHPK .

1.2 Ndryshimi i emrit te shoqerise mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise.

NENI 2


Forma

2.1 Shoqeria tregtare "**IRIS&CO**" SHPK ., ka formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne Dajt, Rrugen **Dajt**, Zona Kadastrale nr.2460, Numer pasurie 203/41-D4 , Kati 1.Tirane.



3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është:

- - ***Tregetim me shumice dhe pakice te artikujve Tabacchi, Duhan paketa artikuj te ndryshem industriale, ushqimore, pije alkoolike jo alkoolike, marrje e dhenje me qera te mjeteve me qera, veshje parafarmaceutike, veshje mjeksore, import-export, zhvillim te ketij aktiviteti dhe ne vende te tjera ne europe;***
- **5.2** Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “**IRIS&CO**” SHPK do të jetë e pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “**IRIS&CO**” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “**IRIS&CO**” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

KREU III

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit



NENI 8

Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat

8.1 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "IRIS&CO" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i gjithi i nënshkruar dhe i shlyer.

8.2 Ortakët kanë kontribuar dhe zotërojnë në kapitalin e shoqërisë kuotat si më poshtë:

- **Z.nja Dallandyshe DOGJANI** atesia Avni zotëron një kuotë me vlerë 100.000,00 (njëqinmijë) lekë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

NENI 9

Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar

9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Zvogëlimi i i Kapitalit të Regjistruar

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.


10.2 Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rastit kur në bazë të ligjit ose të statutit Asamblea e Përgjithshme mund të vendosi ndryshe.

NENI 11

Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar

11.1 Kuotat e kapitalit mund të kalohen tërësisht ose pjesërisht pa asnjë kufizim midis ortakëve të shoqërisë.

11.2 Kuotat e kapitalit mund t'u kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve që nuk bëjnë pjesë në shoqëri me kushtëzimet e mëposhtme:



- Ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshirojnë të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë.

Ortaku që dëshirojnë të shesë kuotën e tij ia ofron atë ortakëve të tjerë nëpërmjet administratorit.

Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, ortakët e tjerë duhet të përgjigjen për ushtrimin e të drejtës së parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ata kanë hequr dorë prej saj. Në rast se ortakët që do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes janë më shumë se një, kuota ndahet ndërmjet tyre në pjesë të barabarta.

- Në rast se ortakët nuk e ushtrojnë të drejtën e parablerjes për kuotën që dëshirojnë të shesë njëri prej ortakëve të shoqërisë atëherë kjo e drejtë mund të ushtrohet nga vetë shoqëria.

Ortaku që dëshirojnë të shesë kuotën e tij ia ofron atë shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtën e parablerjes së kuotës me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim që ortaku mund t'ia shesë këtë kuotë një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, shoqëria duhet të ushtrojë të drejtën e parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet se ajo ka hequr dorë prej saj.

Në rast se shoqëria vendos ta ushtrojë të drejtën e parablerjes ajo duhet të autorizojë administratorin për të blerë kuotën dhe të vendosë anulimin e saj. Në këtë rast, shoqëria duhet të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vlerën nominale të kuotës së anuluar. Si pasojë e këtij zvogëlimi të kapitalit do të ndryshojë edhe raporti i pjesëmarrjes në kapital të ortakëve të shoqërisë.

- Në rast se ortaku që tjetëron kuotën e vet, ia shet atë një të treti jashtë shoqërisë, me çmim dhe kushte më të favorshme nga ato që ua ka ofruar ortakëve dhe shoqërisë për efekt të ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata e shitjes që ortaku do të lidhë me personin e tretë do të jetë e pavlefshme.

11.3 Të gjitha njoftimet në funksion të zbatimit të këtij neni do të bëhen me shkrim me letër të porositur (rekomande).



KREU IV
Organet e Shoqërisë

NENI 12
Asambleja e Përgjithshme

Organi vendimmarrës i shoqërisë është **Asambleja e Përgjithshme**.

NENI 13
Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

13.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve, për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- anulimin e kuotave;
- largimin ose përjashtimin e ortakut;



- dhënie e miratimit administratorëve, për të vepruar lidhur me kufizimet e parashikuara në nenin 18 të statutit.

NENI 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

14.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

14.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

14.3 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.

14.4 Ortakët e shoqërisë janë të detyruar të depozitojnë me shkrim dhe regjistrojnë në Librin e Ortakëve, pranë administratorit të shoqërisë, adresën në të cilën do t'i dërgohet letra e porositur (rekomande) dhe adresën e postës elektronike. Njoftimet për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme do të dërgohen në adresat e regjistruara në Librin e Ortakëve. Dërgimi i njoftimit në këto adresa do të konsiderohet si njoftim i kryer rregullisht

14.5 Ortakët do të njoftohen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë të një letre të porositur (rekomande) ose postës elektronike, e cila u dërgohet në adresën që rezulton nga Libri i Ortakëve, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë.

14.6 Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Për tërheqjen e dokumentacionit që do të shqyrtohet në mbledhje ortakët mund t'i drejtohen me shkrim administratorit ose mund t'i tërheqin në selinë e shoqërisë.

14.7 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës së mësipërme ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët e shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje ose të përfaqësuar dhe janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë së thirrjes.

14.8 Njoftimi për mbledhje, në rast se në rendin e ditës përfshihen çështje për të cilat kërkohet një votim me shumicë të cilësuar, do të bëhet me të dyja mënyrat, si me letër të porositur (rekomande) ashtu edhe me postë elektronike.

14.9 Asambleja do të quhet e vlefshme që në mbledhjen e parë. Në rast se një nga ortakët paraqet një kërkesë për shtyrje për një shkak të arsyeshëm, ortakët e tjerë prezent me konsensus do të përcaktojnë datën kur do të mbahet mbledhja tjetër, gjë e cila do të pasqyrohet në një procesverbal.



Caktimi i kësaj date nuk përjashton detyrimin e personit që ka thirrur mbledhjen për të njoftuar ortakët që mungojnë, për datën e re të mbledhjes.

14.10 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në selinë e shoqërisë, në zyrën e shoqërisë në Tiranë ose në një vend tjetër të përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 15

Pjesëmarrja në Vendime

15.1 Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjesëtim me kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë.

15.2 Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asambleshë e Përgjithshme nga një ortak ose nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

15.3 Ortaku nuk mund të përfaqësohet në Asambleshë e Përgjithshme nga Administratori.

NENI 16

Kuorumi

16.1 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të quhen të vlefshme në rast se në to marrin pjesë personalisht ose janë të përfaqësuar ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

16.2 Për marrjen e vendimeve të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

16.3 Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, miratimin e kalimit të kuotave të të tretët, ushtrimin e së drejtës së parablerjes së kuotave nga shoqëria, anulimin e kuotës së kapitalit, largimin e ortakut dhe për të gjitha çështjet e tjera të parashikuara nga ligji dhe për të cilat kërkohet një shumicë e cilësuar.

NENI 17

Procesverbali i Mbledhjes



17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Mbajtësit të Procesverbalit, rezultatet e votimit.

17.2 Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i Mbledhjes cakton një Mbajtës Procesverbalit, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbajtësi i Procesverbalit.

Procesverbalit i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 18 *Administratori*

18.1 **Administratori** është organi ekzekutiv i shoqërisë.

Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori kryen të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë dhe përfaqëson shoqërinë tregëtare në marrëdhënie me të tretët për sa i përket realizimit të objektit të shoqërisë.


- Administrator i shoqërisë emrohet **Z.nja Dallandyshe Dogjani**, lindur në Osmanaj- Kukes me 28.12.1978 i identifikuar me ID nr. **034249567**.
- Administratori do të kryej të gjitha veprimet për administrimin e shoqërisë.

18/3 Administratori, për operativitet, **Z.nja Dallandyshe DOGJANI** të drejtën e paraqitjes pranë të gjitha bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, dhe në emër të Shoqërisë "**IRIS&CO**" **SHPK**, në llogaritë që kjo shoqëri ka ose do të ketë, të kryejë të gjitha veprimet si depozitime, tërheqje apo tranferta bankare, të lejuara nga ligji si dhe pagesa të ndryshme që kanë lidhje me aktivitetin e shoqërisë, njësoj sikur administratori të ishte prezent, të nënshkruajë në emrin e tij çdo dokument të nevojshëm, pa qënë i nevojshëm ndonjë autorizim tjetër specifik..

18.4 Administratori i shoqërisë mund të delegojë kryerjen e detyrave të administrimit tek një person i tretë jashtë shoqërisë.

KREU V

Eksperti Kontabël, Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve



NENI 19
Eksperti kontabël

19.1 Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një ekspert kontabël të autorizuar, të emëruar nga Shoqëria.

NENI 20
Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

20.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

NENI 21
Shpërndarja e Fitimeve

21.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU VI

Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë, Largimi dhe Përfundimi i Ortakëve

NENI 22
Riorganizimi i Shoqërisë



22.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore. Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 23

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

23.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Shoqëria nuk prishet në rast humbje të zotësisë, vdekje ose falimentimi të njërit prej ortakëve.

Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

23.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 24

Largimi dhe Përfundimi i Ortakëve

24.1 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendim për largimin ose përfundimin nga shoqëria të një ortaku.

Për largimin ose përfundimin e ortakut do të zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KREU VII

Dispozita të Fundit

NENI 25

25.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim.

Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 26



26.1 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky STATUT përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Tirane 21/07/2021

ORTAKU THEMELUES

Dr. Ilir Indri 

AKT THEMELIMI

I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"IRIS&CO" SHPK

Ortakët themelues të Shoqërisë :

- **Z.nja Dallandyshe DOGJANI** atësia Avni zoteron një kuotë me vlerë 100.000.00 (njëqinmijë) leke, që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

mbledhur në Tiranë sot me datë 21/07/2021,

VENDOSËN:

Të krijojnë së bashku një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartojnë" dhe miratojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1.

Emri

1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj "**IRIS&CO**" SHPK

1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.

NENI 2 Forma
juridike

2.1 Shoqëria tregtare "**IRIS&CO**" SHPK ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

NENI 3

Selia

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Dajt, Rrugën Dajt, Zona Kadastrale nr 2460, Nr Pasurie 203/41-D4, Kati 1, Tiranë.

3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

3.3 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.



NENI 4 Vula e shoqërisë

4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

4.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar;

NENI 5 Objekti i Veprimtarisë

5.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë si më poshtë:

- - *Tregetim me shumice dhe pakice te artikujve Tabacchi, Duhan paketa artikuj te ndryshem industriale, ushqimore, pije alkoholike jo alkoholike, marrje e dhenje me qera te mjeteve me qera, veshje parafarmaceutike, veshje mjeksore, import-export, zhvillim te ketij aktiviteti dhe ne vende te tjera ne europe;*
- 5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 6 Kohëzgjatja e Shoqërisë.

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 7 Kapitali i shoqërisë dhe Kuotat

7.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100.000 lekë.

- **Z.nja Dallandyshe DOGJANI** atesia Avni zotëron një kuotë me vlerë 100.000,00 (njqinmijë) lekë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

7.2 Ortakët, në bazë të kërkesës së organit administruar, mund të sjellin para në shoqëri sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjesëshmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.

7.3 Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga Ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

NENI 8 Organet e Shoqërisë

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2 Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 9 Administratori

9.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

- 9.2 Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z.nja Dallandyshe DOGJANI** atesia Avni zotëron një kuotë me vlerë 100.000,00 (njqinmijë) lekë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

NENI 10 Dispozita të fundit

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Përsa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit, dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

NENI 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt themelimi përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

